

UDHËZUES

PYETËSOR PËR KOMUNITETIN NË KUADËR TË “ZHVILLIMIT TE PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR BERAT - GJIROKASTËR”

PËRSHKRIMI DHE QËLLIMI I PYETËSORIT:

Pyetësoni është hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe ka qëllim konsultimin dhe mbledhjen e informacioneve / opinioneve nga banorët, vizitorët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në kuadër të projektit: “Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të IntegrUAR (PMI) për Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë”. Ky projekt është ndërmarrë nga IKTK nën koordinimin e Qendrës së Trashëgimisë Botërore UNESCO.

KOHËZGJATJA DHE PUNA NË TERREN:

Puna në terren do të realizohet në 5 ditë qëndrimi. Studentët do të realizojnë plotësimin e pyetësorëve nën koordinimin e IKTK-së, CHwB-së dhe Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) të Beratit dhe Gjirokastrës.

REZULTATET E PRITSHME:

Pyetësorët do të plotësohen në terren në format të printuar. Të gjithë pyetësorët e plotësuar do të kalohen në format digjital, nëpërmjet ngarkimit të të dhënave në pyetësorin në format (google forms). Në fund të procesit, pyetësorët e plotësuar në format të printuar do të dorëzohen pranë IKTK-së. Rezultatet e tij do të jenë pjesë e dokumentit final të PMI Berat dhe Gjirokastrë.



NUMRI I PJESËMARRËSVE I SYNUAR:

Synimi është plotësimi i 10-15 pyetësorëve në ditë, për secilin student. Pyetësoni është i përbërë nga 15 pyetje, përgjigjet e të cilave janë me alternativa.

VENDI I ZHVILLIMIT:

Berat
Gjirokastrë

Grup - mosha:

Nga 16 vjeç deri në +50 vjeç

 <http://iktk.gov.al/>

 Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore